



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1428/Prot.  
19

Tiranë, më 14.10.2021

**VENDIM**

Nr. 122, datë 14.10.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
ME SHOQËRINË “MAGI EUREGIO”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, neni 3, pika 4, gërma “c” si dhe në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës neni 20, pika “s”, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 14/10/2021,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Shoqërinë “MAGI EUREGIO”
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

Prof. Dr. Agron KASA



**LOGO MAGI**



**MARRËVESHJE KUADËR  
PËR VEPRIMTARI BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR DHE  
MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT TË INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR TË  
SPORTIT**

**NDËRMJET**

**MAGI EUREGIO** Società Cooperativa ONLUS, me seli legale në Bolzano (BZ), Italia, Via Maso della Pieve 60/a, CF 02781770215, e përfaqësuar nga Dr. Matteo Bertelli, lindur në Desenzano del Garda (BS) më 16/03/1973

**DHE**

**UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS (UST)**, me seli legale në Tiranë (Tr), Shqipëri, Rruga “Muhamet Gjollësia”, A1-1001, e përfaqësuar nga Prof. Dr. Agron Kasa, Rektor

**parashtruar se:**

- **MAGI EUREGIO** është themeluar me qëllim: 1) zhvillimin studimeve dhe kërkimit shkencor në fusha të nutri-gjenomikës, metabolomikës, biologjisë dhe gjenetikës së performancës fizike 2) përhapjen e njohurive mbi teknologjitë e reja si ato gjenetike, të biologjisë molekulare dhe biologjisë së performancës fizike për mes organizimit të aktiviteteve, kurseve formative, kongreseve dhe takimeve që nxitin e lehtësojnë përhapjen e këtyre njohurive, 3) financimin e projekteve specifike të kërkimit për zhvillimin e universiteteve dhe qendrave kërkimore në vendet në zhvillim, 5) financimin e formimit të kërkuesve shkencorë të rinj italianë dhe nga vendet në zhvillim, 6) financimin e nismave dhe qendrave të diagnostikimit e kërkimit në vendet në zhvillim;

MAGI synon të arrijë qëllimet e tij përmes:

- Drejtimin dhe administrimin e një laboratorit me seli në Tiranë, të specializuar për kërkimin shkencor dhe diagnostikimin e sëmundjeve gjenetike që aktualisht janë pak të njohura e studjuara;
  - Zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të kërkimit në bashkëpunim me qendra të tjera të interesuara.
- **Universiteti i Sporteve të Tiranës** është universitet publik, themeluar në vitin 1960 dhe që zhvillon veprimtari akademike dhe kërkimore në fushën e shkencave të lëvizjes, të aktivitetit fizik dhe shëndetit dhe të rehabilitimit motor. Misioni i UST është formimi universitar i studentëve dhe përgatija e specialistëve në të gjitha ciklet e studimit, kualifikimi i personelit

akademik dhe kërkimor në sektorët e edukimit fizik, të shëndetit, rehabilitimit motor dhe të veprimtarive rekreative, si dhe promovimin e zhvillimit të kërkimit shkencor në këta sektorë, si dhe ofrimin e shërbimeve të specializuara për palë të tjera në fushat e saj të kompetencës.

Në kuadër të veprimtarive të parashikuara në këtë marrëveshje kuadër, UST synon::

- Krijimin e lidhjeve të bashkëpunimit për kërkim shkencor në fushën e zbatimeve të markatorëve biologjikë dhe gjenetikë në kuadër të shkencave të lëvizjes, aktivitetit fizik në shërbim të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve që lidhen me sedentaritetin dhe shkallën e ulët të aktivitetit fizik;
- Bëhet ejsë e kërkimeve bashkëkohore mbi efektetshëndetsore dhe patologjike që rrjedhin nga obeziteti, pamjaftueshmëria e aktivitetit fizik, mbështetur në indikatorët biologjikë, molekularë e gjenetikë; dhe
- Veprimtari që synojnë fuqizimin e Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit përmes transferimit e zhvillimit të njohurive bashkëkohore të personelit të saj kërkimor në fushta e sipërpërmendura.

#### **duke qenë se:**

- MAGI EUREGIO ka tashmë një projekt të miratuar kërkimor (shiko bashkëngjitur) që ka si objektiv përcaktimin e rolit të varianteve të rralla të gjeneve që lidhen me trofizmin muskular në të rinjtë e rritur që shfaqin “obezitet sarkopenik” dhe për “exercise responder”.

hartohet kjo marrëveshje kuadër bashkëpunimi si më poshtë:

#### **Neni 1 - Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi midis palëve, që integron e gërsheton veprimtarinë kërkimore të Universitetit të Sporteve të Tiranës (IKSHS) dhe ato të MAGI EUREGIO, dhe koordinimin e tyre përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Mbledhjen e kampioneve biologjike dhe të dhënave nga të paktën 200 (dyqind) studentë, në mënyrë anonime dhe vullnetare, dhe përmes pyetësorëve dhe matjeve për dietën ushqimore dhe aktivitetin fizik/sportiv (bashkëngjitur përshkrimi i projektit);
- Promovimin e zhvillimit të Qendrës kërkimore (IKSHS) të Universitetit përmes transferimit të njohurive në këto fusha kërkimi;
- Shqyrtojë, analizojë e konsiderojë mundësitë për vendosjen e një bashkëpunimi afatgjatë në fushat e kërkimit shkencor të këtij projekti apo të tjera me interes reciprok/të përbashkët.

#### **Neni 2 - Objekti-fusha specifike i/e bashkëpunimit**

Obeziteti i shoqëruar me humbjen e masës dhe forcës muskulare (sarkopenia) është një problem madhor i shoqërisë moderne, kur jeta sedentare shoqërohet në të njëjtën kohë dhe me një dietë ushqimore të paekuilibruar. Faktorët gjenetikë të rezistencës ndaj sarkopenisë janë ende pak të studjuar. Megjithatë është hedhur hipoteza se ka një lidhje të fortë midis asetit gjenetik dhe trofizmit muskular.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të:

- a) përcaktojë rolin e varianteve të shpeshta dhe të rralla të gjeneve që lidhen me trofizmin muskular tek të rinjtë adultë me “obezitet sarkopenik” dhe “exercise responder”.

b) Evidentimin e lidhjeve midis varianteve gjenike këtyre gjeneve dhe formave të ndryshme të trofizmit muskular në 700 subjekte të moshës mbi 18 vjec, të klasifikuar në të rinj-adultë me obezitet sarkopenik, normo dhe hipertrofi, duke ndërlidhur më tej rezultatet gjenetike me analiza funksionale, biometrike e molekulare.

Objektiva të tjera janë:

- Identifikimi i varianteve të reja gjenetike të lidhura me përgjigje të ndryshme trofike ndaj ushtrimit fizik;
- Studimi i lidhjeve midis gjenotipeve e fenotipeve muskulare, vecanërisht midis variabilitetit gjenetik dhe ndryshimeve funksionale (forca, fleksibilitetit, rezistenca), strukturale (masa muskulare), biokimike (teste metabolomike, Dozime unike të IL-6 dhe interleukinave të tjera, miostatinës, faktorëve të rritjes qarkulluese, IGF dhe të tjera), karakteristika si në kushte bazale ashtu si përgjigje ndaj stimulimit trofik (stërvitjes së standardizuar të forcës ose proceseve specifike ushtrimore me turrje muskulare aktive).

### ***Neni 3 - Angazhimi i palëve***

Për arritjen e qëllimeve dhe kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në këtë marrëveshje kuadër, Universiteti i Sporteve dhe MAGI EUREGIO angazhohen të lejojnë aksesin e personelit të caktuar për këtë projekt në mjedsiet respektive dhe përdorimin e pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive kërkimore.

Personeli i përfshirë në këtë projekt bashkëpunimi, si dhe strukturat dhe pajisjet e vëna në dispozicion nga palët, do të definojnë në marrëveshjet specifike midis personit përgjegjës të MAGI dhe atij përgjegjës të UST-IKSHS.

MAGI angazhohet të kryejë analizat gjenetike të kampioneve që vijnë nga UST, përpunimin e të dhënave në bashkëpunim me personelin UST përgjegjës i projektit dhe të hartojnë e prezantojnë publikime shkencore të përbashkëta me të dhënat e mbledhura dhe të analizuar në kuadër të projektit.

MAGI angazhohet të garantojë mbështetje financiare për bashkëpunorët e zgjedhur nga Universiteti (IKSHS), që do të ndihmojnë mbledhjen e kampioneve/të dhënave dhe të ftojë pranë laboratoreve të tij për formim të specializuar personelin e Universitetit gjatë kohës së zhvillimit të projektit.

UST angazhohet të garantojë pjesëmarrjen e të paktën 200 (dyqind) studentëve të saj, të përzgjedhur mundësisht nga programet e ndryshme të studimit, të moshës mbi 18 vjec:

UST angazhohet të verë në dispozicion të këtij projekti personel akademik kërkimor të fushës së projektit dhe personel mbështetës (laboratorik), për realizimin e fazës së mbledhjes së të dhënave, matjeve të parashikuara në projektin bashkëngjitur dhe administrimin e pyetësorëve me subjektet studentë të përfshirë.

### ***Neni 4 - Personat përgjegjës të projektit***

MAGI EUREGIO cakton si person referent dhe përgjegjës të kësaj marrëveshje Dott. Matteo Bertelli, President i MAGI EUREGIO

Universiteti i Sporteve të Tiranës cakton si person referent dhe përgjegjës të projektit Prof. Dr. Dhurata Bozo, Përgjegjëse e Departamentit të Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit, Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit, UST

#### ***Neni 5 - Përdorimi i rezultateve të studimit dhe kërkimit***

Zhvillimi i patentave/risive që rrjedhin nga studimet e kësaj popullate (rreth 1 e treta e popullatës së përgjithshme të studuar) dhe të dhënat e sistemit informatik, biokimik dhe gjenetik të tyre janë të MAGI MAGI, me përjashtim të publikimeve shkencore dhe njohurive që i transferohen universitetit lidhur me metodologjitë dhe sistemet e kërkimit. Pas depozitimit të patentës/risive dhe paraqitur publikimet shkencore, bashkëpunimi do të vijojë duke i dorzuar Universitetit (IKSHS) alikuota të biobankës të kampioneve për krijimin e një database që do mundësojnë zhvillimin e kërkimeve të tjera të ardhshme nga IKSHS, e cila vlen në të njëjtën kohë edhe për MAGI.

#### ***Neni 6 - Zhvillimi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes, rinovimi dhe e drejta për tu tërhequr***

Objekti i kësaj marrëveshje është marrja e kampioneve dhe të dhënave nga 200 subjekte vullnetare, sipas ushëzimeve të projektit bashkëngjitur, brenda muajit Janart 2022.

Marrëveshja kuadër ka vlefshmëri prej 1 viti e gjysmë nga firmosja e saj dhe mund të rinovohet me akt formal nga organet kompetente të palëve.

Palët mund të tërhiqen nga kjo marrëveshje përmes komunikimit zyrtar me paranjoftim të paktën tre muaj; prishja e kësaj marrëveshje nuk prodhon efekte automatike mbi raportet ekzistuese në momentin e tërheqjes, të cilat rregullohen sipas përcaktimeve në aktet përkatëse të tërheqjes.

#### ***Neni 7 - Mosmarrëveshjet***

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë ekzekutimit të kësaj marrëveshje, nga palët do të caktohet një kolegji/grup i përbërë nga 4 ekspertë, 2 të caktuar nga MAGI dhe 2 nga UST, për të arritur një dakordësi me të paktën 3 vota.

#### ***Neni 8 - "Të dhënat e rezervuara".***

Nocioni "Të dhëna të rezervuara" përfshin çdo të dhënë me gojë dhe/ose të shkruar, dhe/ose material, dhe/ose instrument, dhe/ose program kërkimi e zhvillimi që MAGI i ofron palës tjetër, ose që përfitohet direkt ose indirekt në çfarëdo forme (në letër, elektronike) që lidhen me këtë projekt kërkimor.

Universiteti i Sporteve angazhohet të mos përdorë të dhënat e rezervuara për qëllime direkt dhe/ose indirekt të ndryshme nga qëllimet e definuara në këtë projekt. Në rastet kur është e nevojshme përfshirja e palëve të treta për zhvillimin e veprimtarive të parashikuara, pala që kërkon angazhimin e tyre duhet të sigurojë firmosjen e një marrëveshje për respektimin e të dhënave të rezervuara të njëjtë me atë të këtij akti. Nuk konsiderohen palë të treta vartësit dhe/ose bashkëpunorët e secilës palë dhe/ose vartësit/bashkëpunorët e shoqërisë.

Secila palë angazhohet të marrë masat e duhura të arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave të rezervuara dhe përhapjen e informacionit të rezervuar sikurse përcaktohet në Marrëveshjen e të Dhënave të rezervuara. Trajtimi eventual i të dhënave personale dhe të ndjeshme në kuadër të të dhënave të rezervuara duhet të bëhet në respektim të normave ekzistuese në fuqi.

PËR MAGI EUREGIO

PËR UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

PRESIDENT

Dott. Matteo Bertelli .....

REKTOR

Prof. Dr. Agron Kasa.....

Data...../...../ 2021